

## ETNICITETI LINGUISTIK DHE TRADITA E ROMËVE NË SHQIPËRI

MELI SHOPI

Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Elbasan, SHQIPËRI  
melishopi@yahoo.it

AKTET V, 4: 692-698, 2012

### PËRMBLEDHJE

Qëllimi i këtij artikulli është pasqyrimi i çështjes rome në fushën sociolinguistike e më konkretisht në atë etnolinguistike. Në të do të gjejmë një studim analitik të përhapjes dhe përqëndrimeve kryesore të romëve në Shqipëri, duke vazhduar më pas me kulturën, zakonet, traditat e hershme dhe të sotme në kushtet e dykulturësisë dhe dygjuhësisë. Përmes vështrimit etnolinguistik: dygjuhësia apo diglosia është bërë një përpjekje për parashtrimin e problemit në nivelin shkencor, duke u mbështetur në materiale e argumente faktike. Të merresh me studimin e historisë së një populli, duke filluar qysh me origjinën dhe zhvillimin historik e kulturor të tij është një punë sa e ndërlikuar, aq edhe e vyer. Shumë është mëtuar në këtë drejtim nga studiues të ndryshëm, historianë apo gjuhëtarë. Njohja e ekzistencës së popujve, të cilët dallohen jo vetëm për territorin gjeografik, por edhe për gjuhën e kulturën, tiparet e gjithçka tjetër, të veçanta dhe të dallueshme, por deri diku edhe të përbashkëta, ndihmojnë në trajtimin apo përpunimin e mjaft koncepteve teoriko - gjuhësore të tyre. Artikulli do t'u vijë në ndihmë të gjithë atyre që kërkojnë të zgjerojnë njohuritë rreth çështjes rome, e cila nuk është trajtuar në nivelin historiko-shkencor sa e popujve të tjerë.

**Fjalë Kyçe:** romët, etnolinguistik, dygjuhësia, diglosia, bashkësi, kultura, zakonet, tradita.

### Hyrja

Gjuhët evoluojnë në mënyra të ndryshme: dialektalizohen ose normativizohen dhe fiksohen përreth një modeli unik. Flasim ndonjëherë për "vdekjen" e një gjuhe ose për "rilindjen" e saj. Kur ndodh që një gjuhë me status social të ndryshëm janë në kontakt me njëra-tjetrën, ato specializohen në fusha të ndryshme të jetës dhe ky fenomen quhet "diglosi"<sup>39</sup>. Kjo e fundit dallohet nga "dygjuhësia" në të cilën statutet dhe përdorimet e të dyja gjuhëve janë në barazi të plotë. Gjuha rome, gjuhë e folur në rreth 50 shtete, pasi të njihete një migracion prej mijëra e mijëra kilometrash, para 1000 vjetësh, është një rast që paraqet interes të veçantë, pasi përmbledh disa tipare të tilla:

Shkëputjen në shekullin 11<sup>-të</sup> të bashkësisë që fliste gjuhë rome nga territori i saj i origjinës: nga India e Veriut në Evropë, pastaj në kontinente të tjera;

- periudha e gjatë e lëvizshmërisë së folësve, lëvizshmëri e shkaktuar në fillim nga persekutimet dhe dëbimet e njëpasnjëshme;
  - ruajtja, thuajse përgjatë një shekulli e një gjuhe të lashtë me një pozicion minoritar gjithkund ku është folur;
  - kontakti me një numër të madh gjuhësh vendore, në më të shumtën e rasteve në formën e të folurave vendore tepër të vjetëruara etj.
- Në lidhje me etnonimin "Rrom" e ka prejardhjen nga "rām", d.m.th. "i bukur, endacak".

<sup>39</sup> Gj. Shkurtaç, "Dygjuhësi dhe diglosi", Sociolinguistika, Tiranë, 2009, Botimi i dytë, f.299.

Në gjuhën rrome “rām” shndërrohet në “rom” dhe dialekti cigan, anglez e tregon këtë transformim.<sup>40</sup>

Ç’mund të themi me prejardhjen e emërtimit rom dhe dallimin midis fiseve?

Rromët janë bashkësi gjuhësore që hyjnë në përbërjen e kombit shqiptar. Pra, cilësohen në Shqipëri si grupe kulturore apo gjuhësore<sup>41</sup> ku si rregull janë asimiluar me shumicën e popullsisë vendase. Vlerësimi i tyre është mbështetur në të dhënat e ndryshme të zyrave të gjendjes civile si dhe nga verifikimet në terren. Pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike të gjitha këto grupe (rumunët, grekët, malazeze, si dhe rromët) të popullsisë gëzojnë administrativisht nënshtetësinë shqiptare. Deri më 1960 rromët e Shqipërisë bënë një jetë nomade. Gjatë periudhës 50-vjeçare rromët nuk mund të dilnin jashtë kontrollit të regjimit, të shtegtonin nga një krahinë në tjetrën. Me ndryshimet demokratike shumë familje rrome kanë ardhur nga qytetet dhe rrethet e tjera të Shqipërisë dhe janë përqëndruar kryesisht në periferi të qytetit të Tiranës, të Elbasanit, Korçës, Pogradecit, etj.

Diçka duhet sqaruar: nuk duhen të ngatërrohen emërtimet e fiseve<sup>42</sup>.

Emërtimi **-arixhi-** është i njëjtë me emërtimin meçkarë. Emërtimi i këtyre të fundit është marrë nga zanati që kryenin në një vend: të gjithë ato që kryenin të njëjtin zana u quajtën të tillë. Në shekullin e 13<sup>-të</sup> u dalluan dy tipe midis tyre të cilëve ishin edhe ata që u quajtën **-rupanë-** (argjend).

Emërtimi **-erli-** (quhen vendasit në Turqi) janë i njëjti fis me emërtimin **-kabuxhi-**.

Emërtimi **-çergarë-** fis që vijnë nga Kosova dhe janë formuar si fis në Jug të Serbisë.


<sup>40</sup> V.de Gila -Kochanowski, “Bulletin de la Société de Linguistiques de Paris”, Mars, 1976.

<sup>41</sup> Atlasi Gjeografik i Popullsisë së Shqipërisë, Struktura etnike e fetare, f.98.

Tri fiset kryesore: **kabuxhinj,** **meçkarë,** **çergarë** janë të shpërndarë përkatësisht në qytetet sipas pikave që tregojn hartat.

<sup>42</sup> M.Courthiade, The Origins of the Romani People: Chronicles and Legends, in Linguistics an Oriental Studies from Poznań, 2005, vol.5, f.273-286.

Nga studimet që janë bërë rreth rromëve dhe fiseve të tyre, është hulumtuar se në Gjirokastrë jeton dhe fisi rromëve që quhet: **vakardët** dhe **bamidhët**.



Ndërsa emërtimi **-kurtof-** nuk përbën fis, por është mbiemri i dy vëllezërve që bëjnë pjesë në fisin e çergarëve. Është për të vënë në dukje se një pjesë e madhe e rromëve ka filluar përsëri të bëjë një jetë nomade. Familje të tëra për 6-7 muaj në vit emigrojnë në Greqi ose në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Të mos harrojmë se nomandizmi i rromëve vazhdon edhe me lagje. Midis të gjithave të këtyre që cituam më lart, nuk duhet lënë pa u përmendur edhe çështja **rromë-egjiptianë,**<sup>43</sup> për të cilët nuk mund të vihet shenja e barazimit midis këtyre dy grupeve. Në të

<sup>43</sup> R.Zemon, Collection d'études sur l'ethnogénèse des Egypciens en Macédoine, Skopje, 1996.

vërtetë romët për më tepër janë bashkësi gjuhësore kulturore, ndërsa egjiptianët janë integruar me popullin shqiptar dhe janë asimiluar plotësisht brenda tij. Të gjithë romët njihen nga afër apo nga larg falë gjuhës rrome. Kjo e fundit ka ardhur bashkë me romët nga India dhe që andej u përhap në të gjithë botën bashkë me ta. Miliona e miliona rromë në Evropë e në Ballkan flasin një rromishte shumë të pastër dhe të saktë. Edhe ata që nuk e flasin mirë, tek ata kanë mbetur pak fjalë të ndryshme ose mbajnë mend pleqtë, të cilët akoma e kanë përdorur ose e përdorin këtë gjuhë. Ndërsa përsa i përket përbërjes, bashkësia e tyre është e ndarë në një numër të grupeve të veçuara, në njësi nëngrupesh dhe metagrupesh, me tiparet e tyre etnike dhe kulturore. Problemet e tyre janë kryesisht të ndryshme në natyrë, por jo të ndjeshme në përgjithësi. Në të kaluarën shpesh është theksuar se romët kanë bërë një jetë endacake pra, kanë qenë gjithmonë në lëvizje dhe banesa kryesore e tyre ka qenë "çadra". Ngritja e tyre zakonisht bëhej nëpër fshatra ku krijonin mëhallat e tyre (lagjet), por vendbanimi kryesor ishte qëndresa buzë lumit ose atje ku kishte ujë. Por gjatë viteve të fundit, shumica e problemeve të kushteve të strehimit dhe jetesës së rromëve kanë qenë deri në një shkallë të lartë, të zgjidhura.

Vetëndarja e qyteteve në lagje të veçanta, mëhalla të përshtatur me shenjë etnike, janë në kornizat e qyteteve (megjithëse më shpesh nëpër rrethina) dhe jo larg apo jashtë tyre. Në vende të ndryshme shpesh romët janë përshtatur dhe në zonat ku ato jetojnë, të cilat nuk janë zhdukur edhe pas Çlirimit ndërsa disa prej zanateve tradicionale janë ruajtur aktivisht deri në vitet 40-50<sup>-të</sup> (jo rrallë deri në ditët tona). Mëhallat rrome nuk ndryshojnë ashtu siç duhet edhe pas Çlirimit dhe në periudhën pas Luftës së Dytë Botërore, këto janë rritur mjaft në krahasim me fundin e shekullit të kaluar, si për arsye të shtesës natyrale të rromëve që jetonin në qytete, ashtu dhe për ekzistencën tek ato të grupeve të mjaftueshme emigrantësh në vendqëndrime të tjera.

Një nga karakteristikat etnokulturore bazë të një bashkësie të dhënë është mënyra e saj e jetesës

që si specialitet të rromët kjo karakteristikë është e lidhur ngushtë me fushën profesionale, *zanatet*. Kanë praktikuar e kanë vazhduar të praktikojnë në një apo tjetër formë zanatet tradicionale: përpunim, meremetime dhe kallaisje të enëve prej bakri, punime kashte, sita, shporta etj. Zanatet që lidhen me migracionet transkufitare janë pikërisht tregtia me kuaj ku këto të fundit janë lidhur kryesisht me një nga zanatet bazë të grupit.

Në kohët e fundit e të sotme këto tradita rilindën përsëri. E veçanta ka qenë lëvizja jashtë kufirit: Greqi, Itali, Turqi, Gjermani, por ka ndodhur edhe e kundërta: ardhja e rromëve, sidomos nga Turqia në Shqipëri.

Në Elbasan janë vendosur pjesa më e madhe e rromëve në lagjen Rrapishtë, në Tiranë në Kinostudio, Laprakë e Nish Tulla, në Pogradec Kulla e Hirit etj., dhe zanati i tyre më i zhvilluar ishte: shportaxhinj, setaxhinj, pra, janë marrë me punimin e kashtës. Më pas i shisnin te fshatarët dhe me paratë që fitonin blinin drithë e sende të tjera për nevojat e tyre familjare. Kishte raste kur i këmbenin në natyrë. Kështu një nga rromët në Elbasan, Safet Rroko, i martuar me 3 fëmijë, pohon se i gjyshi ka ardhur nga Izmiri (Turqi) dhe janë përqëndruar në Korçë dhe në Elbasan. Arsyja e lëvizjes ka qenë për punë tregtie, ngaqë kanë qenë zona të ngrohta. Tregtia bëhej me drithëra (nuk kanë pasur ara e tokë), shisnin shporta e kanistra dhe me të ardhurat blinin drithin te fshatarët. Ajo bëhej me kafshë njëthundrakë. Më vonë kjo lloj tregtie u zëvendësua me shitjen e copave e të veshjeve e më tej me tregtinë e floririt. Pra, çergarët e Elbasanit në Shqipëri merreshin me këtë lloj tregtie, ndërsa kabuxhinjtë në Vlorë me punime kallaisjeje, saça etj. Fisi i meçkarëve në zonën e Fierit nuk janë marrë me tregti, por vetëm kanë punuar toka, si bujq (Roskovec, Levan) etj.<sup>44</sup> Është interesante të theksohet që ata ruajnë prirjen për punë me kafshët, sidomos për punë sezonale apo të përhershme në ferma kafshësh. Kurse

<sup>44</sup> Këto citime janë nxjerrë nga shfrytëzimi i materialeve gjuhësore të punuara dhe të skeduar për studime gjuhësore në lidhje me gjuhën rrome.

lojërat me arinj dhe majmunë u janë lënë anëtarëve më të rritur të familjes. Shikimi i fatit përmes dorës zakonisht bëhet nga gratë më të moshuara në moshë. (Hedhja e fallit ka qenë një nga karakteristikat e punës së grave rrome).

Një nga veçoritë, karakteristikat e kësaj bashkësie është botëkuptimi fetar specifik i romëve që e gjen shfaqjen e tij dhe në kalendarin e caktuar festiv vjetor. Rromët në tërësi nuk janë lidhur me institucionet fetare dhe me shërbyesit e tyre, edhe pse i festojnë festat kalendarike në rrethin apo mjedisin e vet familjar. Ato nuk janë të varur në këtë drejtim as nga kisha dhe as nga xhamia.

P.sh. festa e Pashkëve Ortodokse dhe të dy Bajramët për rromët myslimanë, u përmbahen datave të popullsisë rreth e rrotull. Popullaritet të veçantë të rromët e grupeve të ndryshme ka Vasilika ose Bango Vasil që festohet më 14 janar. Në përgjithësi ditët festive lidhen kryesisht me gostitë e ndërsjellta të të afërmëve dhe miqve (në vend të parë me kumbarët) të shoqëruara më tryeza të pasura dhe orkestra (muzikë).

Pashkët festohen, megjithëse në variante të ndryshme, nga të gjitha bashkësitë rrome. Ky festim është parë nga afër në qytetin e Korçës. Festë tjetër e popullarizuar është dhe *Dita e Shën Gjergjit (6 Maj)*, ndoshta, me emërtime të ndryshme, por që është dhe mbetet e njëjta festë. Baza me të cilën lidhet kjo festë është "kurban" i qengjit. Ndërsa për rromët myslimanë ekziston festa e dy Bajramëve: Ramazan Bajram (sheqer Bajram) dhe Kurban Bajram (Koç Bajram, si ndonjëherë festohen shfaqje si dy festa të veçanta). Karakteristikat bazë të sistemit etnokulturor të romëve në Shqipëri, si dhe nëndarjet e veçanta të bashkësisë rrome mund të vihen re te ekzistenca e zakoneve dhe këndimeve fetare familjare. Rromët gjithmonë kanë qenë të dëgjuar për dashurinë e madhe ndaj fëmijëve dhe për familjet me shumë fëmijë.

Familja dhe fëmijët tek ata janë çmimi ose pasuria bazë, kurse gruaja pa fëmijë mund të jetë shkak i lejueshëm për shkatërrimin e martesës. P.sh. te grupet që ruajnë me fanatizëm zakonet si: vjehrra ka të drejtë të përzejë nusen, kur ajo nuk lind etj. Në të kaluarën vdekshmëria

foshnjore të rromët ka qenë jashtëzakonisht e lartë. Sipas disa llogaritjeve arrinte deri 60-80%, prandaj deri në ditët e sotme funksionon një aktivitet i pasur me cikël zakonesh për sigurimin e shëndetit të fëmijës dhe të gruas – nënë nga ana tjetër. Urimi bëhet nga të gjithë pjesëtarët e familjes, të cilët kapin një send prej hekuri, kur pritët lindja e fëmijës dhe urohet në rromisht:

*"Te ovell tu mengje sa sto the pur holl shelle bre shengo tovell!"*

*(Me jetë të gjatë e 100 vjeç, plak me mjekërr!)*  
*"Baht(x) alló te ovell!" (Past' kismet!)*

Interesant është problemi me emrat vetjakë (personalë). Si në Shqipëri edhe nëpër botë është e përhapur gjerësisht vendosja e "emrit të dyfishtë" d.m.th. ekzistenca e një emri të fshehtë rromi dhe tjetri "zyrtar" që përpara makrobashkësisë zakonisht shpjegohet me tabuzimin e emrit të vet përpara të huajve. Emri i fëmijës më parë vendosej vetëm pas 40 ditëve, kurse sot ky zakon nuk ekziston. Ka raste që bëhet edhe duke kujtuar emrat e të parëve, sidomos ato që kanë vdekur në një moshë shumë të re.

Veçanërisht momenti më i rëndësishëm në jetën e romëve është edhe *dasma*. Te grupet e romëve të ruajtura dhe të funksionuara mirë forma bazë e martesës është "*blerja e nuses*", d.m.th. pagesa e blerjes, prindërve të vajzës nga ai që do ta marrë për t'u martuar. Ky lloj zakoni ka qenë dhe mund të flitet për kohë më të hershme, pasi sot nuk praktikohet. Opinioni i prindërve është i detyrueshëm edhe te martesat me anë të "*dashjes*", d.m.th. kur dasmat bëhen me zgjedhje nga ana e dy të rinjve, por me rënie dakort të dy fiseve, të cilët vendosin dasmën e ardhshme. Moshë martesore të rromët në tërësi është e ulët: 15-16 vjeç vajza dhe 17-18 vjeç djali. Dasma për rromët është treguesi i vetëm i lidhjes së çiftit në martesë, kurse aprovimi zyrtar nuk ka rëndësi të veçantë për ta dhe zakonisht kryhet vite pas dasmës. Jo rrallë dhe për shkak të pamundësisë, kjo ndodh në moshat e vogla të të posamartuarve, sidomos nuses që pritët të mbushë moshën. Shitja, blerja, dhuratat për të

porsamartuarve dhe në përgjithësi dasmat e mëdha, janë vetëm shfaqje të normave bazë, të çmuara të bashkësisë etnike rrome, por edhe formë e mbajtjes së jetës sociale, të përbashkët apo të nëndarjeve të veçanta të kësaj bashkësie.

Në plan të parë, i veçantë është “shkëmbimi i vlerave” në kornizat e bashkësisë konkrete rrome me anën e së cilës kryhet integrimi i saj, sigurohet ruajtja dhe ekzistenca si njësi etnosociale në kornizat e makrobashkësisë. Nga studimet që janë bërë në terren, në pjesën më të madhe të qyteteve ku jetojnë romët në Shqipëri vihet re një ngjashmëri e madhe e ceremonive, por sidomos ajo e dasmës me grupet e tjera kurbate në Ballkan. Kështu, p.sh. qysh në fillim me përzgjedhjen e krushqisë nuk kryhen martesë me egjiptianë. Mund të ndodhë në ndonjë rast të rrallë, por nuk është në traditë. Ndërsa martesë me të bardhët ose siç i quajnë romët ndryshe “gaxhinj”, janë kryer dhe njihen mjaft raste të tilla: p.sh. në Elbasan dhe në Tiranë.

Në një familje të njohur rrome të zotit Nebi Mustafai, i cili do të fejonte djalin e tij 14 vjeç, dërguan një lajmës për të rënë dakort të dy palët. Komunikimi midis tyre bëhet në gjuhën rrome dhe kur vendosin për lidhjen e çiftit vendosin edhe për dasmën. Komunikimi brenda fisit është mjaft i lirshëm dhe asnjë anëtar i bashkësisë rrome nuk has vështirësi për t’u marrë vesh me njëri-tjetrin. Vështirësia e komunikimit ndodhë fis me fis. Por ka raste që martesë nuk kryhet sipas traditave të vjetra, por sipas kërkesave të sotme bashkëkohore. Zakonet dhe këndimet fetare të lidhura me vdekjen dhe varrimin janë shumë të ngjashme te nëndarjet e grupeve të ndryshme të bashkësisë rrome në Shqipëri e kudo. Vihen re besime për ngjarje që do të ndodhë në lidhje me vdekjen si: plasaritje të mureve në shtëpi, e qara e qenit, zë kukumjaçke dhe më tepër besime në ëndrra të ndryshme që shoqërojnë njeriun (rënia e një dhëmbi apo ëndrra me shtëpi prej druri) etj. Në kohërat më të reja veçanërisht me popullaritet të grupeve të caktuara rromësh u bënë të ashtuquajtura “varreza”. Në përgjithësi te romët, të gjithë të ndjerët varrosen në të njëjtën mënyrë. Zakoni i mbetur e që trashëgohet, madje deri në ditët e sotme (në ndonjë rast) është se,

atje ku ndodh vdekja, atje bëhet varrimi dhe varri njëkohësisht.

P.sh. një pjesë e varreve të romëve të Elbasanit janë në Lurë, sepse dikur romët kanë qenë të përqëndruar atje. Dhe jo vetëm në Lurë, por edhe në shumë vende të tjera, sidomos atje ku rridhte lumi dhe ngrinin çadrat e tyre.<sup>45</sup> Kurse sot ka ndryshuar gjithçka. Romët atje ku banojnë atje dhe varrosen.

Disa elemente të kulturës etnike, elemente që përcaktojnë shumë probleme etnologjike po i paraqisim dhe po i prezantojmë në vazhdimësi. Duhet të theksojmë se te anëtarët e këtij etnikumi ekziston një ndërgjegje etnopsikologjike për dallim etnik prej etnikumeve të tjera që jetojnë në afërsi të tyre dhe ajo që duhet theksuar është se etnikumet e tjera asnjëherë nuk i kanë pranuar në rrathët e tyre etnike. Mirëpo kjo popullsi është e përvetësuar me vlerësimet e saj kulturore prej etnive të ndryshme, për interesa të ndryshme.

Tek anëtarët e këtij etnikumi shumë herë përdoren fjalët: “*tonët, tonës, dora jonë*” etj., që në një mënyrë e fshehin përkatësinë e tyre etnike. Ata tregojnë se nuk janë as shqiptarë, as turq, as vllahë (çobanë), as grekë e kështu me radhë deri te romët, të cilët dallohen nga të gjithë këto etnikume. Pas vendosjes nëpër vendet e ndryshme të botës, edhe në Shqipëri romët formuan bashkësi etnike specifike të vetat, të cilat megjithëse janë të afërta me atë të Indisë së vjetër, kanë tiparet e veta tipike dhe çdo gjë vetëm e tyre.<sup>46</sup>

Natyrshtëm shtrohet pyetja: Ku qëndron ndryshimi i një grupi rromësh nga tjetri dhe pse specifika profesionale në mënyrën e jetesës së tyre e ka humbur rëndësinë e tyre?

Ajo që e bën të dallueshme këtë bashkësi nga bashkësitë e tjera është **gjuha**. Ajo integron bashkësinë, siguron shkëmbimin e informacionit, por mund të jetë pengesë për grupin e izoluar dhe pjesëtarët e saj të veçantë. Më e shumta e

<sup>45</sup> Këto pohime janë marrë nga goja e vetë romëve, siç është biseda me Xhemal Mustafai lindur dhe rritur në Pogradec tregon prejardhjen e tij nga Izmiri (Turqia).

<sup>46</sup> M.T.Salo, Gypsy Ethnicity: Implications of Native Categories and Interaction for Ethnic Classification, Ethnicity 6, 1979.

grupeve rrome flasin dialektet e tyre në gjuhën rrome “romani çib”,<sup>47</sup> me përjashtim të gjuhëve jorrome ( të folura shqip, hungarisht, turqisht, rumanisht etj.). Gjuha e rromëve kudo është e ndikuar nga gjuha e popullsisë, në mjedisin e të cilit ata jetojnë ose kanë jetuar. Veçoritë dialektore, huazimet e ndryshme nga gjuhët e grupeve të veçanta, ndihmojnë për ndarjen midis tyre, por për shkak të bazës së përgjithshme dhe për shkak të faktit që s’ka grup, i cili mund të mos jetë në ndikimin dygjuhësor, gjuha nuk është pengesë për të arritur komunikimin midis anëtarëve të bashkësisë. Shtojmë këtu se situatë e dygjuhësisë është atëhere kur njeriu shërbehet rrjedhshëm, sipas situatave të jetës së tij të përditëshme, nga dy gjuhë për të komunikuar me të tjerët dhe kur këtë komunikim dygjuhësor e pranojnë si mjedisi ashtu edhe situata e përgjithshme sociolinguistike.<sup>48</sup>

Mund të vërtetohet që çdo grup rrom përcaktohet nga gjuha ose dialekti dhe kjo gjuhë e karakterizon atë si grup. P.sh. meçkarët, kabuxhinjtë dhe çergarët dallohen secili për dialektin e tyre. Njësoj si profesioni, mënyra e organizimit të jetesës edhe gjuha e grupit rrom mundet lehtësisht të ndërrohet me një tjetër dhe kjo jo vetëm me gjuhën e popullsisë rreth e rrotull (shembuj për të cilët janë grupet jorrome gjuhësore), por edhe me një tjetër dialekt rrom. Për këtë të fundit ka vërtetime të mjaftueshme në literaturë. Rromët mund të shfrytëzojnë gjuhën e tyre dhe si mjet për vetizolim gjatë kontakteve me bashkësinë rrethuese, kur nuk duan të jenë të kuptueshëm, pra në kushtet e dygjuhësisë apo të diglosisë. P.sh. në Elbasan, në Tiranë, në Bilisht dhe në ndonjë zonë tjetër të Shqipërisë, në bisedat dhe takimet që kemi bërë me tregtarë rromë, madje i kemi dëgjuar edhe vetë gjatë blerjes e shitjes, rezulton se ata i përshtaten mjaft mirë mjedisit rrethues ku ata punojnë e jetojnë dhe në shumicën e rasteve ata komunikojnë shqip. Por kur kërkojnë që të mos i marrësh vesh se ç’duan

të thojnë me njëri-tjetrin ata komunikojnë në gjuhën rrome.

Ja ç’thotë njëri nga rromët në një moment të veçantë të pritjes me miqtë:

...Shitësja e lagjes ku jetojnë vetëm rromë mund të marrë vesh gjithçka, por ka raste kur nuk i kupton njerëzit, ajo përdor shenjat sipas emërtimeve përkatëse (kur i flasin shqip).

Pra, gjuhën shqipe rromët e kanë mësuar thjesht, vetëm nëpërmjet komunikimit të përditshëm, kontakteve me njerëzit që i rrethojnë apo që punojnë. Jo vetëm kaq po ka raste kur kanë shkuar edhe në shkollë dhe kanë mësuar dhe mësojnë mirë gjuhën shqipe. Xhemaliu është një ndër ata që e njeh mirë jo vetëm shqipen, por edhe greqishten, turqishten, jugosllavishten, arabishten. Për çudi brenda familjes së tij flitet vetëm e vetëm rromisht. Nga studimet dhe vëzhgimet mbi grupet e rromëve del se kudo ata kanë humbur vijat klasike të bashkë bashkësisë njerëzore ose organizatës gjinore dhe në këto kohëra vërtëtojnë si gjithmonë ekzistencën e tyre si dhe elasticitetin dhe aftësinë për t’u përshtatur ndryshimeve të mjedisit rrethues. Së fundi, mbrojtja e gjuhës jo gjithmonë ka qenë në program të shoqatave rrome. Megjithatë Kongresi i Parë Botëror Rrom, mbledhur në Londër, më 1971, shpalli barazinë e dialekteve dhe nuk pranoi zgjedhjen e një një dialekti të privilegjuar, si bazë e një gjuhe të përbashkët dhe zgjedhjen e një gjuhe qëndrore si:

“...Asnjë dialekt nuk qëndron më lart se të tjerët. Gjithsesi na duhet një dialëkt qëndror, i normalizuar që ne do të mundim ta përdorim në Kongrese dhe shtypin ndërkombëtar...”

Ai publikon gjithashtu një projekt të parë alfabeti dhe krijon Komisionin Gjuhësor të

Bashkimit Rrom. Ky proces shërbeu si pikënisje për të gjitha zhvillimet e mëvonshme që në vendimtare nga viti 1971 der në vitin 1990 për përpunimin e asaj që quajnë “Gjuha e përmbledhjes” që në vendimtare nga viti 1971 der në vitin 1990 për përpunimin e asaj që quajnë “Gjuha e përmbledhjes” që në vendimtare nga viti 1971 der në vitin 1990 për përpunimin e asaj që quajnë “Gjuha e përmbledhjes” që në vendimtare nga viti 1971 der në vitin 1990 për përpunimin e

<sup>47</sup> M. Courthiade, *Śirpustik amare çhibăqiri*, Agencia Occitana de Communication, Besièrs, 1992

<sup>48</sup> Gj.Shkurtaç, *Sociolinguistika*, Tiranë, 2009, f.283.

asaj që quajnë “Gjuha e përmbledhjes”. Njëra prej konstatimeve kryesore është se nëse ka mungesë fjalori të huaj që kanë ndërhyrë në çdo anë, në gjuhën rrome, baza e vjetër (shpesh quhet preballkanike, edhe pse është ndërtuar para arritjes apo takimit me ballkanasit), është në një unitet të paraprë.

Pra, gjuha rrome paraqitet si një larmi varietetesh dialektore e të folmesh. Kjo larmishmëri vihet re pjesërisht edhe në nivelin e gjuhës së përbashkët. Të flasësh për unifikim të plotë të trajtave dialektore nuk është i arritshëm, aq më tepër i dëshirueshëm, sidomos në kushtet e përndarjes së kësaj popullësie në Shqipëri e në vendet e tjera të Ballkanit. Studimet gjuhësore të arrira nga studiues shqiptarë, por edhe të huaj me punimet e tyre tregojnë se romët edhe pse më ndryshime dialektore flasin të njëjtën gjuhë rrome, rromishten. Gjithashtu edhe ekzistenca e varianteve të të folurit, duke ruajtur karakterin e tyre nuk bëhen pengesë apo të paraqesin vështirësi për komunikim brendapërbrenda bashkësisë. Ky është edhe elementi që i mban romët të lidhur në një bashkësi. Ato janë të përqëndruar në vendbanime të caktuara si banues të qëndrueshëm të tyre. Pra, nuk mund të flitet më për jetë endacake apo gjysmendacake, si dikur. Sot lëvizja e tyre lidhet vetëm për punë a çështje tregtie.

Puna dhe njohja nga afër me njerëz të kësaj bashkësie, sidomos në qytetet Elbasan, Korçë, Pogradec, Tiranë tregojnë se anëtarët e saj dalloheshin për një organizim të mënyrës së jetesës dhe përdorimin e mjeshtrive të ndryshme. Fusha më e spikatur ku romët tregonin veçantinë e tyre ishte ajo e muzikës ku shquhen si virtuozët më të mëdhenj të muzikës popullore me instrumentet e tyre të veçanta etj. Njohja nga afër me shumë cilësi shpirtërore, me mënyrën e jetesës e ligjërimin konkret të një mjedisi tipik rrom vihen re karakteristika të veçanta. Të bën përshtypje se janë ata që i bëjnë më shumë ballë kohës dhe se ndryshimet janë të dallueshme vetëm në formë dhe rrallë në përmbajtje. Por mesazhet që duan t’u dërgojnë brezave që vijnë janë të qarta dhe të kuptueshme. Ajo që duhet theksuar është se

romët u janë përshtatur vendeve ku banojnë jo vetëm me gjuhën me një shqipe të pastër, por dhe me zakonet e traditat vendase. Pra, nëpërmjet elementeve të ndryshme të etnokulturës, e sidomos në elementet e kulturës shpirtërore, njohjes e analizës së tyre të çojnë në zbulimin e gjurmëve të kësaj bashkësie në faza të ndryshme të zhvillimit shoqëror dhe ekzistencës së saj.

### Referencat

- Atlasi Gjeografik i Popullsisë së Shqipërisë, Struktura etnike e fetare.  
Gj.Shkurtaç, Dygjuhësi dhe diglosi, “Sociolinguistika”, Tiranë, 2009, Botimi i dytë.  
Gj.Shkurtaç, Sociolinguistika, Tiranë, 2009, f. 283.  
M.Courthiade, The Origins of the Romani People: Chronicles and Legends, in “Linguistics and Oriental Studies From Poznan”, 2005.  
M.T.Salo, Gypsy Ethnicity: Implications of Native Categories and Interaction for Ethnic Classification, Ethnicity 6, 1976.  
M.Courthiade *Śirpustik amare çilibăqiri*, Agencia Occitana de Communication, Besièrs, 1992.  
R.Zemon, Collection d’études sur l’ethnogenèse des Egiptiens en Macédoine, Skopje, 1996.  
V.de Gila-Kochanowski, “Bulletin de la Société de Linguistiques de Paris”, Mars, 1976..